




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

 Naser Fejzullahu Ekspert Shqyrtues	Data e autoizimit të ekspertit 16.01.2023	Data e dorëzimit të raportit 24.01.2023
---	--	--

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.01.2023, "Graniti Sh.p.k.", ka parashtruar ankesë me Nr: 39/23, kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1; Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura të hapur, lloji i kontratës: Furnizime, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000,00 € vlerë e madhe.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 01.11.2022, data e hapjes së ofertës 13.12.2022, data e Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 29.12.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjyqësorëve dhe Zyra të Shkrimorëve për Gjykatën dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Ankesa e OE

"Graniti Sh.p.k.",

1. Te dhenat mbi aktivitetin e prokurimit

Njoftimi për Kontrate: 02.12.2022

Data e hapjes së ofertave: 13.12.2022 Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 29.12.2022

Kërkesa për

rishqyrtim: 04.01.2023

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 05.01.2023

3. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

☒ PO

Hapja është bërë në mënyrë elektronike

4. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e metutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po X

Jo

Njoftimin mbi vendimin e AK dhe letren standarde për tenderuesin e pasuksesshem i kemi pranuar në e-prokurim me 27.07.2022.

5. Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po x

Jo

/

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimave dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykatat dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Neni 1 i LPP-se
Neni 7 i LPP-se
Neni 59 i LPP-se
Neni 60 i LPP-se
Neni 64 i LPP-se
Neni 61 i LPP-se
Neni 69 i LPP-se.
Neni 41 i Rregullores së prokurimit publik Nr.001/2022

7. Deklarate detale mbi faktet dhe argumente

Te nderuar ne me dt. 29.12.2022 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se ku e ka rekomanduar per kontrate OE "MOBELLAND" SH.P.K, ndersa neve na ka shpallur si tenderues te pasuksesshem.

AK-ja ka rekomanduar per kontrate nje OE i cili eshte i papergjegjshem sepse nuk ka ofertuar konform kerkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

Tek kerkesat e FDT-se mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eshte kerkuar: Inventari le deshmohe me fotografij per secilin artikuj (perjashtimisht sallave te gjykimit dhe zyrave te shkrimoreve). si deshmi dokumentare te ofrohet: Katalogu per artikujt e ofruar nga OE per secilin vef e ver te Evidentohen sipas numrit Rendor.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem per faktin se NUK ka prezantuar katalog dhe specifikacion teknik konform kerkeses se dosjes se tenderit. OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar vetem foto dhe ato foto i ka kopjuar bashke me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto te marra nga dosja e tenderit. Andaj ky fakt tregon qarte se OE i rekomanduar per kontrate nuke ploteson kerkesen e lartcekur per faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kerkeses se dosjes se tenderit. mirepo fotot i ka kopjuar nga dosja e tenderit, ku ky fakt vertetohet shume lehte nese analizohet oferta e OE te rekomanduar per kontrate, mirepo AK haptas ka bere favorizime.

Po ashtu edhe keto foto apo i menduari si katalog i ofruar nga OE i rekomanduar per kontrate ne shume pika nuk ofron deshmi dhe te dhena te sakta ne lidhje me materialin dhe specifikat tjera te kerkuar. Edhe teksti ku pershkruhen te dhenat e produkteve pothuajse jane te njejtat, ku thuhet qe duhet te jene, ndersa diku teksti eshte pershtatur. Prandaj deshmohe qarte se ky OE eshte i pa pergjegjshem dhe si i tille eshte dashur te eliminohe nga AK-ja dhe jo te shpallet fitues.

Ne nenin 6.4 te FDT-se nder te tjera eshte kerkuar:

- Vertetimin e Gjykates kompetente. Nje dokument te leshuar nga Gjykata kompetente qe permbush "kerkesat e pershtatshmerise" Te mos jete me i vjeter se tre muaj para Njoftimit per Kontrate, kurse si deshmi e kerkuar dokumentare - Vertetimin e gjykates dokumenti dorezohet prane AK-se para njoftimit mbi vendimin e AK-se. ne rast te deshtimit te dorezimit te ketij dokumenti, tenderi (oferta) ne fjale dote refuzohet. Gjate qasjes ne dokumentacion ne kemi verejtur se ky vertetim nuk eshte dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate, prandaj edhe per kete arsye AK ka bere shkelje sepse OE eshte i papergjegjshem.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk ka dorezuar edhe vertetimin nga Administrata Tatimore e Kosoves, ndersa ne nenin 6.4 te FDT-se eshte kerkuar - Vertetimi i ATK

duhet të jete original me bar cod, dokumenti dorezohet prane AK-se para njoftimit mbi vendimin e AK-se. Ne rast të deshtimit të dorezimit të këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjale dote refuzohet"

Ne mungese të ketyre dokumenteve OE i rekomanduar për kontrate është i papergjegjshëm dhe është dashur që në fillim të eliminohet nga gara.



Ne nenin 9.1&9.2 të FDT është kërkuar "Ofertuesi duhet të ofroj deshmi se ka kontrate apo kontrata të perfunduara furnizim me inventar në tri vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontrate, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatoreve ekonomik jo më e vogël se: Gjashtëgind Mijë Euro; 600,000.00 €, kurse si deshmi dokumentare është kërkuar "Lista e kontratave të realizuara së bashku me referenca. Ose raportin e pranimit nga komisioni ku në raport konstaton se kontrata është përmbyllur në tërësi nga data e hvies në fuqi deri në datën e përmbylljes në kohezgjatje prej Vite, Muaj, Dite)

OE nuk ka prezantuar kontrata për referencat e ofruara, kurse kontratat janë të viteve 2018 dhe 2019, ndërsa referencat i ka të vitit 2021!!!! prandaj këto deshmi nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, A.K është dashur MOS e favorizoj O.E







Ne FDT, tek neni 9.1&9.2 i FDT-se është kërkuar si vijim: "OE duhet ta ofroj katalogun për secilin artikuj dhe të evidentohen sipas numrit Rendor dhe të deshmohet me fotografi për secilin artikuj.

OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar katalog për secilin artikuj vec e vec dhe nuk i ka evidentuar por i ka vendosur disa foto të shlyera dhe nuk duken se çfarë produkte janë dhe se cka janë.






OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar edhe me cmime jo normalisht të ulte, ndërsa të disa produkte ka ofruar cmime shumë më të larta se sa cmimet e tregut, prandaj rezultojnë se ky OE ka ofertuar me cmime manipulative.

Cmime Manipuluse			
Nr. Artikullit	Artikujt	Cmimet shumë të ulëta manipuluse	Cmimet shumë të larta manipuluse
	Tavoline pune për zyrë 140x70x74 		100 euro
	Tavoline pune për administratë (zyrë) 160x70x74 	50 nuk është munder që tavolina më e madhe të kushtojë më lirë.	
	Tavoline pune për zyrë e vogël 125x125x74cm	35 euro	



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

			
	Tavoline për Kompjuter 80x70x73cm 	<u>30 euro</u>	
	Kabinet për gjyqtar me tavoline pune me kend 160x80x90x80cm 		<u>200 euro</u>
	Tavoline për takime për 8 karrige 	<u>35 euro</u>	
	Tavolina për takime për 22 persona 	<u>40 euro</u>	
	<u>Karrika levizese për Gjyqtar</u>		<u>220 euro</u>
	<u>Karrika levizese për Zyrtar</u>		<u>100 euro</u>
	<u>Karriga statike për pale</u>		<u>50 euro</u>
	<u>Karriga statike për tavolina të mbledhjeve</u>	<u>30 euro</u>	
	<u>Ulese për pritje për 3 persona</u> 	<u>45 euro</u>	





Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
 Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
 Nr. i brendshem 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

	<p><u>Vitrine e hapur</u></p> 		<u>100 euro</u>
	<p><u>Frigorifer</u></p> 	<u>60 euro</u>	
	<p><u>Komod per TV</u></p> 	<u>30 euro</u>	
	<p><u>Vitrine me 6 dyer per zyre</u></p> 	<u>50 euro</u> <u>Si eshte e</u> <u>mundur</u> <u>me kushtu</u> <u>ma lire</u> <u>vitrine 6</u> <u>dyer se</u> <u>vitrina 4</u> <u>dyer.</u>	
	<p><u>Vitrine me 4 dyer per zyre</u></p> 		<u>150 euro</u>




Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
 Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimëve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
 Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

	<p>Vitrine me 2 dyer per zyre</p> 	<p><u>45 euro</u></p>	
	<p>Fotele nje ulese per pritje</p> 	<p><u>35 euro</u></p>	
	<p>Fotele dy ulese per pritje</p> 	<p><u>40 euro</u></p>	
	<p>Fotele tre _ulese per pritje</p> 	<p><u>50 euro</u></p>	
	<p><u>Rafte per shkrimore</u></p>		



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

	<p>Rafte per shkrimore 2</p> 	50 euro	
	<p>Rafte Metalike per Arkiv - 2</p> 	35 euro	
	<p>Rafte per Arkiv tipi - 3 Dim.100 x 40 x 200cm Konstruksioni te punohet nga tuba metalik 25x25 mm, me muri te tubit 2 mm</p> 	45 euro	
	<p>Kasete metalike me kater sirtar</p> 	60 euro	
	<p>Ormanet Metalik dy dyer dim. 200x90x41cm</p>		



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
 Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
 Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 Iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

		<u>62 euro</u>	
	<p>Ulëse për pritje në holle</p> 	<u>40 euro</u>	
	Karrikat për publikun, në sallën e gjykimit		<u>220 euro</u>
	<p>Tavolinë në sallë të gjykimeve për 3 gjyqtar</p> 	<u>35 euro</u>	




Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
 Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-ZZ-12042-1-1-1;
 Nr. i brendshem 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

	<p>Tavolinë në sallë të gjykimeve për 5 gjyqtar</p> 	<p><u>40 euro</u></p>	
	<p>Tavolina për prokuror dhe për avokat.</p> 	<p><u>35 euro</u></p>	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
 Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
 Nr. i brendshem 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,


	<p>Tavolina e procesmbajtësit</p> 	<p>35 euro</p>	
	<p>Tavolinë për dëshmitar</p> 	<p>35 euro</p>	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

	<p>Rrethoja ndarëse ne sallën e gjykimit</p> 	10 euro	
	<p>Veshja e mureve me iver pllaka</p>	65 euro	
	<p>Tavolinë pune për vendosjen e paisjese ne dy nivele me gjerësi 280 cm</p> 	40 euro	
	<p>Tavolin pune për vendosjen e paisjeve ne dy nivele me gjerësi 195 cm</p> 	35 euro	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
Furnizim me Inventar për Salla të gjyqimëve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1;
Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Nr	Artikujt	Origjina	
9	Karrika lëvizëse për Gjyqtar	Nuk prodhohen ne Kosovë	
10	Karrika lëvizëse për Zyrtar	Nuk prodhohen ne Kosovë	
12	Karrika statike për tavolina të mbledhjeve	Nuk prodhohen ne Kosovë	
18	Frigorifer	Nuk prodhohen ne Kosovë	



Duke u bazuar ne tabelen e mesiperme shihen qarte cmimet jo normalisht te uleta ne pozicionet qe i cekem e po ashtu shihen edhe cmimet shume te larta ne krahasim me cmimet e tregut, e ku kuptohet qarte qe OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar cmime manipulative.

Autoriteti kontraktues, nuke ka zbatuar nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te Rregullores Nr.001/2022 pe prokurim publik sepse nuk ka kerkuar sqarime per 9mimet jo normalisht te uleta dhe te larte edhe pse keto cmime nuk mund te arsyetohen fare.

Ne dyshojme qe ky tender eshte i kurdisur sepse O.E Mobelland i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me cmime manipulative, kur themi kurdisje tenderit shihet qarte se cmimet e ofruara nuk jan cmime te tregut sepse kemi dy EKSTREMITETE cmime shume te larta dhe cmime shume te uleta.

Dyshojme qe OE i rekomanduar per kontrate ka marrveshje sepse artikujt qe duhet te porositen jane cmime te larta kurse artikujt qe nuk kerkohen jan cmime ekstremisht te uleta!!!!

Ne si popull apo shoqeri jemi te brengosur se si nje Institucion shume i rendesishem i shtetit tone Keshilli Gjyqsor i Kosoves apo njera oder shtyllat kryesore te Republikes se Kosoves punohet e veprohet ne kete menyre, rekomandohet per kontrate O.E me mime manipulative me te vertet eshte shume per tu brengos!!!!

Gjithashtu sic e sqaruam me larte per produktet qe jane te vendosura ne fund te tabelës, ato produkte nuk kane origjine nga OE i rekomanduar per kontrate sepse nuk prodhohen ne Kosove sic ka pretenduar OE i rekomanduar per kontrate, edhe KGJK e dine shume mire sepse keta nuk jetojn ne hene por ne Kosove

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyet e eliminimit te OE "Euro Testing shpk" te cilat AK-ja i ka cekur ne letren standarde per tenderues te eliminuar.

Ne me dt. 05.01.2023 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkeses për rishqyrtim me arsyetimin se njëjta është e pa bazuar, mirepo që AK-ja nuk ka arsyetuar me fakte dhe deshmi konkrete vendimin për refuzimin e kërkeses tone për rishqyrtim.

AK-ja në vendimin e saj për refuzimin e kërkeses për rishqyrtim në lidhje me pretendimet tona ankimore, sa i përket kontratave dhe vertetimeve nga gjykata dhe ATK, ka bashkangjitur deshmitë, e të cilat deshmi neve gjatë qasjes së dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë ofruar, mirepo ne nuk e dijmë se kur i ka ofruar keto dokumentet, OE i rekomanduar për kontratë, pasi që askund nuk figuron data se kur janë prezantuar deshmitë të cilat i ka bashkangjitur AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkeses për rishqyrtim, pra ne dyshojmë se ato AK i ka pranuar pasi ne kemi bërë kërkesë për Rishqyrtim.

Se AK-ja po e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë vertetohet shumë qartë ky fakt, ku e njëjta nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, pasi që nuk ka dhënë përgjigje fare në lidhje me cmimet mëtejse të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. E njëjta nuk ka dhënë përgjigje fare as në pretendimin tjetër ankimor, në lidhje me produktet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për të cilat ne e kemi çekur se të njëjtat nuk prodhohen në Kosovë, pra ne dyshojmë se këtu ka korrupsion.

Perderisa AK-ja nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet të cilat i çekem me lartë atëherë kuptohet qartë fakti se pretendimet tona ankimore, janë të qëndrueshme, pasi që nëse të njëjtat nuk do të ishin të qëndrueshme atëherë AK-ja do të kundërshtonte të njëjtat me fakte dhe deshmi konkrete. Pra nga ky fakt kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga AK-ja dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu AK-ja në lidhje me pretendimin tone ankimor sa i përket kinse katalogut të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku ne e kemi çekur se i njëjti katalog është vetëm kopje e specifikave teknike të cilat AK-ja i ka prezantuar në dosje të tenderit, AK-ja kete pretendim e ka çësuar site pa bazuar.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkeses për rishqyrtim në lidhje me pretendimin tone të lartçekur, e njëjta e eek se OE i rekomanduar për kontratë ka dorezuar katalogun mëtejse të cilin deshmon se janë ofruar të gjithë artikujt sipas dosjes së tenderit. Ky konstatim i AK-së është i pa bazuar për faktin se ne në kërkesë për rishqyrtim e kemi çekur qartë se i njëjti OE ka prezantuar vetëm foto dhe ato foto ka kopjuar bashkë me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto të marra nga dosja e tenderit Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën në lidhje me katalogun për faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkeses së dosjes së tenderit, andaj edhe arsyetimi i AK-së është i pa bazuar.

Duke u bazuar në të gjitha deshmitë dhe faktet që u çekem me lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve nuk është here në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhenie të kontratës e që ka qenë tenderi përgjegjshëm me cmim me të ulët të peshuar, pra nuk është respektuar kriteri kryesor për dhenie të kontratës sipas nenit 60 të LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashihet qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirepo ju nuk jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, edhe pse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet

publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues është detyruar të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-se, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "GRANITI SH.P.K"

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se për dënie të kontratës dhe Jenda të kthehet në RIVLERSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-se.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

/

Mundësia e shpërblimit me kontratë.

3. KRITERI PËR VLERSIM

Tenderi i Përgjegjshëm me çmim më të ulët

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERSUES

Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ofertave në përzierje të plot prej tre (3) anëtarësh kanë bërë vlerësimin konform LPP, nenit 59. Për fitues të kontratës shpallin Operatorin Ekonomik: "Mobelland" Sh.P.K. Suhareke 1 cili e plotëson të gjitha kërkesat administrative, të teknike të kërkuar në dosje të tenderit dhe ka ofruar çmimin më të ulët.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Nuk ka

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. PËRGJIGJE NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES "Graniti Sh.p.k."

Pretendimin ankimor 1

OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm për faktin se NUK ka prezantuar katalog dhe specifikacion teknik konform kërkesës së dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar vetëm foto dhe ato foto i ka kopjuar bashkë me specifikimet nga dosja e tenderit, pra ka vendosur foto të marra nga dosja e tenderit. Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se nuk e ka prezantuar katalogun konform kërkesës së dosjes së tenderit. Mirepo fotot i ka kopjuar nga dosja e tenderit, ku ky fakt vërtetohet shumë lehtë nëse analizohet oferta e OE të rekomanduar për kontratë, mirepo AK haptas ka bërë favorizime.

Përgjigja në pretendim 1

Në pretendimin ankimor të kompanisë Ankuse "Graniti shpk" së AK-së Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka rekomanduar kompaninë "Mobelland shpk" pa i plotësuar kriteret e vlersimit të përcaktuar në dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar kriteret e vlersimit të shpallur në dosjen e tenderit : **Kërkesa- Inventari të deshmohej me fotografi për secilin artikull (përjashtimisht sallave të gjyqimit dhe zyrave të shkrimorëve)** konstaton se kërkesa- kriteri i vlersimit të tenderit nuk është kërkuar katalog i fortë apo katalog prodhuesi por është kërkuar që të dorëzohen fotografi të inventarit që është kërkuar në dosjen e tenderit për secilin artikull në bazë të fakteve që i kemi analizuar kompania e rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kriterin e kërkuar nga AK-ja. Kërkesa e dosjes së tenderit është kërkuar që të dorëzohen fotografi të inventarit për artikujt dhe kompania e rekomanduar për kontratë ka dorëzuar fotografi të inventarit ashtu siç ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit.

Prandaj duke marrë për bazë nenin 59 të LP-së është në diskrecion të AK –së të gjitha dokumentet e kërkuara dhe që janë vendosura në dosjen e tenderit , duhet të jenë drejtpërdrejt relevant dhe proporcionale në raport me kriteret e vlersimit dhe për këtë kompania e rekomanduar për kontratë dokumentet që kanë dorëzuar në oferte janë proporcional me kriterin e vlersimit.

Gjithashtu kompania e rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike ku ka deklaruar se mallra që do të furnizohet do të jenë në përputhje me specifikimin teknik të kërkuar në dosjen e tenderit me këtë ekspert shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pa bazuar , e AK-ja lidhur me këtë pretendim në plotëni ka respektuar nenin 59 të LPP-së.

Sa për Informimin e panelit shqyrtues unë si ekspert mendoj se deshmimi i dorëzuar – katalogun që është si pretendim ankimor i kompanisë ankuese është përafshishtë i njëjtë i të dy kompanive asaj të rekomanduar dhe kompanisë ankuese , vetëm kompania ankuese e ka me ngjyra . Mirpo kërkoj nga paneli shqyrtues të vërtetojë dhe të krahasoj vetë pasi katalogu të dy kompanive është i printuar si katalogu.

Pretendimin ankimor 2

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar edhe me çmime jo normalisht të ulte, ndërsa të disa produkte ka ofruar çmime shumë më të larta se sa çmimet e tregut, prandaj rezulton se ky OE ka ofertuar me çmime manipulative.

Përgjigja në pretendim 2

Artikujt që janë të grumbulluar në një tabel dhe janë të poentuar me përqindje nuk mundet të cilësohen si çmime manipuluese pasi përqindja prej (45% Te Pikeve tabela e listave të çmimeve) e poentuar i përaftron me çmim konkurrent të tregut dhe ligji nuk njeh në këtë procedurë si çmime manipulative pasi AK i ka poentuar tabelat e artikujve përqindjen me të madhe apo me të vogël varësisht ku e ka pas interesin AK-ja të marrë çmime me të favorshme në interesin e AK-se.

Pra sa më e madhe është vlera e një artikulli kur përpjesëtohet me 45% zbritja në çmim është më e madhe.

Sipas RRPP nënit 17.35 AK të kontratave me çmime për njësi AK duhet të përcaktoj peshat në baze të rëndësisë së secilës kategori të artikujve ose grup të artikujve në atë mënyrë që AK-se të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit dhe në baze të kësaj AK-ja ka vepruar në përputhje me LPP-në e i ka barazuar të gjithë OE.

Gjithashtu në baze të nënit 61 të LPP-së për çmime jo-normalisht të ulët është në kompetencën e AK-së dhe ka të drejtë të vendosë për të sqaruar për çmime jo-normalisht të ulët me OE, kur ai e parashef se çmimet janë shumë të ulta dhe ka rrezik për mos realizim të kontratës. Tenderet jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, në këtë rast për AK-në çmimet kanë qenë të besueshme.

OE i rekomanduar për kontratë "Mobelland shpk" në këtë rast është si OE prodhues dhe çmimet e një prodhuesi për mallrat që i prodhon vetë dhe i shetë vetë çdo herë mundohet të të del në treg me çmime me të favorshme se çmimet e mallrave tregtare apo mallrave që importohen nga jashtë. Kjo në ekonomi njifet si politike e çmimeve që prodhuesit vendore dëshirojnë të mbizotrojnë mbi çmimet tregtare.

AK-ja e ka parapa për këtë arsye i ka grupuar artikujt e i kanë peshuar që mos me pas kësaj manipulime të çmimeve dhe në baze të fakteve të krahasuara ekspert shqyrtues konstaton se pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi 3

Në nenin 9.1&9.2 të FDT është kërkuar "Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka kontratë apo kontratë të perfunduara furnizim me inventar në tri vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatoreve ekonomik jo më e vogël se: Gjashtëgind Mijë Euro; 600,000.00 €, kurse si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e kontratave të realizuara së bashku me referencë. Ose raportin e pranimit nga komisioni ku në raport konstaton se kontrata është përfunduar në tërësi nga data e hvies në fuqi deri në datën e përfundimit të kohegjatje prej Vite, Muaj, Dite)

OE nuk ka prezantuar kontratë për referencat e ofruara, kurse kontratat janë të viteve 2018 dhe 2019, ndërsa referencat i ka të vitit 2021!!!! prandaj këto dëshmi nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, AK është dashur MOS e favorizoj O.E.

Përgjigjja në pretendim 3

Në baze të listës së Referencave që ka dorëzuar me oferte kompania e rekomanduar për kontratë shifet qarte se është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit që është kërkuar në pikën 9.1/9.2 të FTD. Në baze të nënit 69 të LPP-së Autoriteti kontraktues duhet të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se

ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe këto kërkesa minimale duhet të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë nga autoriteti kontraktues për OE, atëherë OE janë të obliguar të plotësojnë kërkesat minimale të kërkuara dhe këto kërkesa minimale i ka plotësuar OE i rekomanduar për kontratë sipas ekspertit shqyrtues. Shikoni vetë këto të tria e plotësojnë kushtin e kërkuar.

Inventarizimi i Dekanatit të F. Mjekësisë dhe njesive tjera të UP-se	Universiteti i Prishtinës	22.11.2019 22.11.2020	242-19-8174-111	412,402.51 euro
Furnizim me inventar në bibliotekë dhe hapsira tjera të Objektit UMB	Universiteti i Mitrovicës	25.03.2020 24.06.2020	97900-19-7261-121	123,450.32 euro
Furnizim me Inventar për shkollat e arsimit parauniversitar .	Ministria e Arsimit	09.07.2020	208-19-7223-111	528,000.00 euro

Ne bazë të këtyre faktëve dhe dëshmive në oferte të OE të rekomanduar për kontratë ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet e kompanisë ankuese "Graniti shpk" janë të pabaza.

Pretendimi 4

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatohet se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është here në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dënie të kontratës e që ka qenë tenderi përgjegjshëm me çmim më të ulët të peshuar, pra nuk është respektuar kriteri kryesor për dënie të kontratës sipas nenit 60 të LPP-së.

Përgjigjja në pretendim 4

Në bazë të raportit të Hapjes së ofertave shihet se kompania e rekomanduar është me çmim më të ulët por këtu e ka vërtetuar edhe komisioni i vlerësimit i cili në përputhje me nenin 59 të LPP-së ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka rekomanduar për kontratë kompaninë me çmim më të ulët. Në bazë të kësaj ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankues se nuk është respektuar neni 59 dhe neni 60 i LPP-së është i pa bazuar.

Pretendimi 5

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka dorëzuar edhe vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa në nenin 6.4 të FDT-së është kërkuar - Vërtetimi i ATK duhet të jetë origjinal me bar kod, dokumenti dorëzohet pranë AK-së para njoftimit mbi vendimin e AK-së. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjale dote refuzohet"

Përgjigjja në pretendim 5

Në bazë të LPP-së nenit 68 Vërtetimi Tatimore duhet të jetë tremujorin e fundit që është kërkuar në këtë rastë Vërtetimi tatimore duhet me qenë jo më i vjetër se TM3, pra OE mundet ta dorëzojë në ATK -TM3 ndërsa sa i përket Vërtetimit të gjykatës ky vërtetim nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë (6) muaj. Në bazë të dokumenteve që ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë këto dokumente e plotësojnë kriterin e kërkuar dhe pretendimi ankues është i pa bazë.

Pretendimi 6

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Graniti Sh.p.k.", lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK me nr Prokurimit Nr. 328-22-12042-1-1-1; Nr. i brendshëm 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-se, sepse na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-se dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-se e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirepo ju nuk jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Përgjigjia në pretendim 6

Gjatë analizimit të Raportit të Vlersimit të ofertave dhe gjithë aktivitetit të Prokurimit eksperti shqyrtues mendon se është bërë Vlersimi i ofertave në përputhje me LPP-në saktisht nenin 7 dhe nuk është diskriminuar asnjëra kompani konkurrese por as kompania ankuese që ka pretenduar se është diskriminuar nga komisioni i vlersimit të ofertave. Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se kompania ankuese nuk ka cek në ankesë asnjë dëshmi/fakt se ku ju është bërë diskriminimi vetëm pretendon se ka qenë kompania e përgjegjshme është dashur të rekomandohet për kontratë në këtë tender. AK-ja sipas raportit të vlersimit dhe B58 -Letrave standarde OE ankues "Graniti shpk" është si OE i pa suksesshëm dhe AK-ja ka vepruar në përputhje me LPP-në se kompania e rekomanduar për kontratë ka çmimin më të ulët konkurrues që vrehet se AK-ja ka respektuar nenin 1, 6 që kompania ankuese "Graniti shpk" ka pas si pretendim ankimor në ankesë dhe në bazë të fakteve dhe dëshmive konstatohet si eksperte shqyrtues se pretendimi ankimor është i pa bazë.

Në bazë të fakteve dhe sqarimeve që kemi shqyrtuar, si dhe përgjigjet e cekura më lart eksperti shqyrtues mendon se Ankesa e "Graniti shpk" të cilësohet e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftim mbi Vendimin e AK –se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e cekura më lartë, Eksperti propozon OSHP-se që të mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-se për tenderin me titull: "Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK, me numër të prokurimit: 328-22-12042-1-1-1, dhe numër i brendshëm: 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) e Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Ankesa e "Graniti shpk" në tenderin e shpallur nga – Këshilli Gjyqësor i Kosovës me titull Furnizim me Inventar për Salla të gjykimeve dhe Zyra të Shkrimoreve për Gjykata dhe SKGJK, me numër të prokurimit: 328-22-12042-1-1-1, dhe numër i brendshëm: 33300/022/038/111 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të cilësohet e pa bazuar.

Raporti i ekspertizës të dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - Këshilli Gjyqësor i Kosovës |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - "Graniti shpk" |